



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:266703
Datë: 31.07.2024
Numri i dokumentit: 06003794
KPPP.nr.2064/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Dav Joni Group” SH.P.K., me NUI:811974949, me seli në Ferizaj, Fshati Pleshinë, kundër debitorit “Kopshti i Fëmijëve Jehonat” SH.P.K., me NUI:812009232, me seli në Ferizaj, rruga “Driton Islami”, përfaqësuar sipas autorizimit nga Kemajl Ademaj, avokat nga Ferizaj, duke vendosur lidhur me kërkesën e debitorit për kthim në gjendje të mëparshme në çështjen përmbartimore sipas prapësimit kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.688/23, të datës 26.10.2023 të Përmbartuesit Privat Bardh B. Tasholli me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datën 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e paraqitur nga debitori “Kopshti i Fëmijëve Jehonat” SH.P.K., për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.688/23, të datës 26.10.2023, të Përmbartuesit Privat Bardh B. Tasholli.
- II. HEDHET POSHTË si i pa afatshëm prapësimi i debitorit “Kopshti i Fëmijëve Jehonat” SH.P.K., i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.688/23 të datës 26.10.2023, të Përmbartuesit Privat Bardh B. Tasholli.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit me datë 26.10.2023, ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.688/23, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. 03/23 të datës 09.06.2023, me të cilën është urdhëruar

debitori që në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të urdhrin t'ia paguaj kreditorit shumën prej 6,893.00 €, me kamat ligjore prej 8% nga dita e kalimit të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore me ndalim të mjeteve në para të cilat debitori i ka në të gjitha llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogaritë e kreditorit, si dhe regjistrimin, konfiskimin, dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe nga shitja e këtyre të realizohet borxhi ndaj kreditorit si dhe të paguhen shpenzimet e procedurës përbarimore në pajtim me tarifin në fuqi.

Debitori përmes përfaqësuesit të autorizuar, me parashtrën e datës 23.11.2023, ka paraqitur kërkesë për kthimin në gjendjen e mëparshme, duke i bashkangjitur edhe prapësimin kundër urdhrin përbarimor P.nr.688/23. Në kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme debitori ka deklaruar se për shkak të neglizhencës së dorëzuesit të postës urdhri nuk i është dorëzuar debitorit, ndërsa përbaruesi privat duke vepruar sipas konstatimit të njëjtit e ka afishuar në tabelën e shpalljeve urdhrin përbarimor. Tutje ka shtuar se pas kalimit të afatit ligjor përbaruesi ka bërë bllokimin e llogarive bankare të debitorit, ku pas interesimit të debitorit me datë 20.11.2023, në zyrën e përbaruesit privat ka bërë pranimin e urdhrin përbarimor. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet si e bazuar kërkesa për kthim në gjendjen e mëparshme, dhe të lejohet si i afatshëm prapësimi i debitorit.

Debitori përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor duke theksuar se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përbarimor nuk ka titull ekzekutiv dhe si tillë nuk ka tipare të përbarueshmërisë. Tutje ka shtuar se fatura e cila është objekti i kësaj procedure përbarimore është e falsifikuar për faktin se e njëjta nuk është nënshkruar nga debitori e as nga personat e autorizuar nga debitori. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, të shfuqizohet urdhri përbarimor, të përfundohet procedura përbarimore si dhe të detyrohet kreditori që debitori t'ia kompensoj shpenzimet e përpilimit të prapësimin në shumë prej 104.00 €.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke theksuar se debitori ka për qëllim vetëm ta zvarris procedurën sepse urdhri përbarimor është nxjerr në përputhje të plotë me dispozitat e LPP-së, pasi që fatura e nënshkruar nga debitori apo përfaqësuesi i saj paraqet dokument të besueshëm, debitori në mënyrë të njëjtë ka pranuar edhe fatura të tjera nga kreditori të cila i ka

paguar në kohë. Tutje ka shtuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se fatura nuk është e përshtatshme për përmbardim pasi që e njëjta i përmban të gjitha elementet e kërkuara, po ashtu e njëjta është e nënshkruar nga debitorit. I ka propozuar gjykatës që të hedhet poshtë si i pabazuar prapësimi i debitorit.

Kërkesa e Debitorit për kthim në gjendje të mëparshme

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se kërkesa e debitorit për kthimin në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimi është e pabazuar për shkaqet si në vijim:

Gjykata gjeti se Përmbarduesi Privat Bardh Tasholli, me datën 27.10.2023 ka tentuar t'ia dorëzoj debitorit në adresën tij urdhrin përmbardimor P.nr.688/23, të datës 26.10.2023, përmes Postës së Kosovës, por zarfi është kthyer me konstatimin se pala është e pa njohur. Nga shkresat e lëndës rezulton se përmbarduesi privat përmes konkluzionit të datës 02.11.2023 për lëndën përmbardimore P.nr.688/23, të datës 26.10.2023, komunikimin me debitorin e ka realizuar përmes afishimit të shkresave në tabelën e shpalljeve.

Sipas nenit 18 të Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbardimore (tutje LPP), përcaktohet se *“Dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, të parapara për dërgimin e shkresave, vlejnë edhe për aktvendimin për përmbardimin, urdhrin për përmbardim, aktvendimin lidhur me prapësimin kundër aktvendimit për përmbardim dhe aktvendimit për gjobën me të holla”*.

Ndërsa, me nenin 114 të Ligjit Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore (tutje LPK) përcaktohet se: *“Në qoftë se dorëzimi i shkresës subjektit të regjistruar në regjistrin publik nuk mund t'i bëhet në adresën e treguar në regjistër, komunikimi bëhet duke u ngjitur shkresa në tabelën e shpalljeve të gjykatës, dorëzimi konsiderohet i kryer pas skadimit të afatit prej shtatë ditësh nga dita e afishimit në tabelën e shpalljeve të gjykatës”*

Në këtë drejtim, Gjykata gjeti se Përmbarduesi Privat, ka zhvilluar komunikimin e shkresave me debitorin konform dispozitës së nenit 114 të LPK-së, duke i afishuar shkresat në tabelën e shpalljes së Përmbarduesit Privat, në pamundësi të komunikimit me debitorin në adresën e regjistruar në regjistrin publik.

Rrjedhimisht, në mungesë të provave të cilat e mbështesin kërkesën e debitorit për kthim në gjendjen e mëparshme, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me ndonjë shkak të arsyeshëm si rezultat i të cilit i është pamundësuar debitorit që ta ushtroj prapësimin ndaj Urdhrit Përmbarrimor P.nr.688/23, të datës 26.10.2023, andaj edhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e refuzuar kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme si të pa bazuar.

Vendosja sipas prapësimit të Debitorit

Meqenëse kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e parashtruar nga debitori rezulton të jetë e pabazuar dhe marrë parasysh faktin se dorëzimi i Urdhrit Përmbarrimor tek debitori është konsideruar si i rregullt me skadimin e afatit prej shtatë (7) ditëve nga dita e afatimit, konkretisht me datë 09.11.2023, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 10.11.2023, rezulton se debitori ka pasur afat shtatë (7) ditë që të ushtroj mjetin juridik të prapësimit, në kuptim të nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore me të cilin përcaktohet se: *“Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarrues ose urdhrit përmbarrues”*, dhe atë jo më vonë se deri më 16.11.2023.

Andaj meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 23.11.2023, e cila vërtetohet nga numri i protokollit 1274/23 i Përmbarruesit Privat Bardh Tasholli, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me 7 (shtatë) ditë vonësë.

Mbi këtë bazë, e në kuptim të nenit 73, par. 3 të LPP-së me të cilin përcaktohet se: *“Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar”* Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktvendimi duke e hedhur prapësimin si të pa afatshëm.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 129, 130 dhe nenit 133.4 të LPK-së, e në lidhje me nenin 68.2 të LPP-së, nenit 73 par. 3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.2064/23, datë 31.07.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.